



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS – VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVA

REPUBLICA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA INSTITUTI I HISTORISË "ALI HADRI" PRISHTINË INSTITUTE OF HISTORY "ALI HADRI" PRISHTINA INSTITUT ZA ISTORIJU "ALI HADRI" PRIŠTINA	
Nr. i prot. P. N. 01/17/24	
Org. Jm. 1.11	
Nr. i Fëmijës 9	Data: 29.02.24
Prishtinë, 2024	

INSTITUTI I HISTORISË "ALI HADRI" PRISHTINË
INSTITUTE OF HISTORY "ALI HADRI" PRISHTINA
INSTITUT ZA ISTORIJU "ALI HADRI" PRIŠTINA

Prishtinë, 26.02.2024

RAPORT I KOMISIONIT RECENSUES

për zgjedhjen e kandidatit për vendin e punës:

*Bashkëpunëtor i lartë shkencor për periudhën në mes të Dy Luftërave Botërore –
zgjedhje/rizgjedhje*

Bazuar në konkursin e shpallur nga Instituti i Historisë "Ali Hadri" në Prishtinë, të publikuar gazetën "Epoka e Re" e datës 29 janar 2024 dhe në ueb faqen e Institutit të Historisë "Ali Hadri" Prishtinë <https://ih-rks.org/konkurs-bashkepunetor-i-larte-shkencor-per-periudhen-ne-mes-te-dy-lufterave-boterore-zgjedhje-rizgjedhje/>, bazuar në nenet 30, 31, 33 dhe 35 të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore (Gazeta e Republikës së Kosovës, nr. 11/02 maj 2013), nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L212, neneve 29, 30, 31, 32, 33 dhe 34 të Statutit të Institutit të Historisë "Ali Hadri" në Prishtinë, dhe nenet 3, 5, 9, 11, 12 dhe 13 të Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve në Institutin e Historisë "Ali Hadri" Prishtinë, si dhe bazuar në vendimin e datës 22.12.2023, Komisioni recensues për vendin e punës *Bashkëpunëtor i lartë shkencor për periudhën në mes të Dy Luftërave Botërore – zgjedhje/rizgjedhje*, në përbërje prof. dr. Sabit Syla - kryetar, prof. dr. Sabile Keçmezi Basha – anëtare, dhe akad. Prof. dr. Frashër Demaj – anëtar, i paraqet Këshillit Shkencor të Institutit të Historisë "Ali Hadri" Prishtinë, këtë:

RECENSION

për kandidatin

Mbështetur në dokumentet dhe dispozitat ligjore mbi të cilat është shpallur konkursi i cekur më sipër si dhe në dosjen e kandidatit të paraqitur, Komisioni recensues ka konstatuar se në konkursin për vendin e punës *Bashkëpunëtor i lartë shkencor për periudhën në mes të Dy Luftërave Botërore – zgjedhje/rizgjedhje*, ka konkurruar vetëm kandidati Armend Mehmeti.

Komisioni recensues pas verifikimit të dokumentacionit relevant dhe mbështetës, të nevojshëm dhe të dëshmuar në CV përkatëse, konstatoi se kandidati Armend Mehmeti i plotëson

kushtet formale-juridike për t'iu nënshtruar procedurave të mëtutjeshme të përzgjedhjes për këtë vend pune, respektivisht për të vazhduar me shqyrtimin e të arriturave profesionale-akademike të kandidatit në përputhje me dispozitat dhe kushtet e cekura në preambulën e këtij konkursi.

Të dhëna bibliografike për kandidatin

Kandidati Armend Mehmeti u lind në Prizren më 13.09.1975. Studimet themelore katërvjeçare dhe ato të masterit shkencor i kreu në Universitetin e Prishtinës – Fakultetin Filozofik, drejtimin Histori. Studimet e doktoratës i ka kryer në Institutin e Historisë – Akademia e Studimeve Albanologjike në Tiranë, më 2017, duke mbrojtur tezën e doktoratë *“Diplomacia britanike mbi marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave 1919-1939”*. Ka punuar ai asistent administrativ dhe përkthyes gjuhësor shqip-anglisht dhe anasjelltas në Misionin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë gjatë viteve 2000-2008 dhe si përkthyes gjuhësor shqip-anglisht dhe anasjelltas në Misionin e Bashkimit Evropian në Kosovë gjatë viteve 2008-2016. Nga 1 prilli i vitit 2020 kandidati Armend Mehmeti punon në Institutin e Historisë “Ali Hadri” Prishtinë në pozitën e *Bashkëpunëtor shkencor për periudhën në mes të Dy Luftërave Botërore*.

Aktiviteti kërkimor-shkencor dhe profesional

Bazuar në nenin 33 pika 2 të *Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore* (Gazeta e Republikës së Kosovës, nr. 11/02 maj 2013) dhe nenit 5, pika 1.3.1 të *Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve të Institutit të Historisë – që ka botuar së paku tri (3) punime shkencore në revistat relevante ndërkombëtare në kuadër të lëmisë dy (2) prej të cilave pas zgjedhjes së fundit - Shtojca I, pika A respektivisht A. 2.1, punimet e publikuara në revista ndërkombëtare të cilat janë të indeksuara në platformat akademike me 1 dhe pika A. 2.2, punimet e publikuara në revista kombëtare, të cilat janë të barasvlershme me 1, të Rregullores në fjalë, kandidati Armend Mehmeti ka këto punime të publikuara:*

Nr	Emri dhe mbiemri	Titulli i punimit	Revista	Vëll. Nr. (viti), fq.	Linku i publikimit
1.	Armend Mehmeti	Midis dëbimit dhe asimilimit-përpjekjet për shpërnguljen e shqiptarëve nga Kosova: Konventa turko-jugosllave e	<i>Studime Historike</i>	Nr. 1 (2023)	https://ih-revista.edu.al/index.php/ih-revista

		vitit 1938			
2.	Armend Mehmeti	Foreign Policy of the Kingdom of Serbs, Croats and Slovenes toward the Albanian Government of Prime Minister Noli	<i>Međunarodne studije</i>	Vol. XXIII. No. 2, 2023 Fq. 27-42	https://hrcak.srce.hr/312564 https://search.worldcat.org/search?q=armend+mehmeti&offset=1 https://essentials.ebsco.com/search?query=armend+mehmeti https://doaj.org/search/journals?ref=homepage-box&source=%7B%22query%22%3A%7B%22query_string%22%3A%7B%22query%22%3A%22medunarodne%20studije%22%2C%22default_operator%22%3A%22AND%22%7D%7D%2C%22track_total_hits%22%3Atrue%7D
3.	Armend Mehmeti	The Migration of Albanians to the United States of America - challenges and achievements during the first two decades of the twentieth century	<i>Anglisticum</i>	Vol. 12 No. 9 (2023) Fq. 16-23	https://www.anglisticum.org.mk/index.php/IJLLIS/issue/view/139 https://essentials.ebsco.com/search?query=armend+mehmeti
4.	Armend Mehmeti	Admission of Albania to the League of Nations	<i>Anglisticum</i>	Vol. 12 No. 12 (2023) Fq. 41-49	https://www.anglisticum.org.mk/index.php/IJLLIS https://search.worldcat.org/title/1332987600 https://essentials.ebsco.com/search/eds?query=anglisticum
5.	Armend Mehmeti	Aksioni i armatosur i Zogut në Shqipëri – aspekte të mbështetjes jugosllave e britanike	<i>Kosova</i>	Nr. 45 – 2020 Fq. 93-110	https://ih-rks.org/
6.	Armend Mehmeti	British and Yugoslav responde to Italian Invasion of Albania	Anglisticum,	Vol 6, Iss 8, (2017) Fq. 20-30	https://www.anglisticum.org.mk/index.php/IJLLIS/issue/view/Vol.6%2C%20No.8%2C%202017 https://essentials.ebsco.com/search?query=armend+mehmeti

Sipas Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve të Institutit të Historisë, përkatësisht **Shtojcës II, pika A, tabela 1.2: Publikimet e monografive studimore, librave me dokumente në gjuhën shqipe**, kandidati Armend Mehmeti ka në procedurë botimi këtë studim monografik:

Nr.	Autori/autorët	Titulli	Lloji i botimit	Botuesi	Vendi dhe viti
1.	Sabit Sylaj, et. al. Armend Mehmeti	Drenica në fokusin e historisë	Libër monografik	Instituti i Historisë Prishtinë	Në procedurë botimi

Sipas Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve të Institutit të Historisë, përkatësisht **Shtojcës II, pika B, tabela 1.2: Publikimet nga sesionet, konferencat, simpoziumet, tryezat shkencore në nivel vendor**, kandidati Armend Mehmeti ka të publikuara ose janë në proces të publikimit:

Nr.	Autori/autorët	Titulli i punimit	Konferenca	Botuesi dhe vendi	Vëllimi, nr. (viti), faqet
1.	Armend Mehmeti	Resurset e naftës faktorë në ndryshimin e relacioneve ndërkombëtare e në Evropë në fillim të shekullit XX	<i>Konferencë shkencore: "Çështja shqiptare në Konferencën e Ambasadorëve në Londër (1912-1913)"</i>	Instituti i Historisë "Ali Hadri" Prishtinë dhe Fakulteti Filozofik/UP Prishtinë, 26 tetor 2023 Në proces të publikimit.	
2.	Armend Mehmeti	Krimet e forcave serbe në Kosovë ndërmjet dy luftërave botërore (1918-1941)	<i>Konferencë shkencore: "Gjenocidi serb kundër shqiptarëve gjatë shek. XIX-XX"</i>	Instituti i Historisë "Ali Hadri" Prishtinë, Instituti i Historisë Tiranë, dhe Instituti Albanologjik Prishtinë, 7-8 prill 2022 Në proces të publikimit.	

Sipas Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve të Institutit të Historisë, përkatësisht **Shtojcës II, pika C, tabela 1.1: Prezantime gojore-shkencore në konferenca, simpoziume, punëtori shkencore dhe në universitete**

(si ligjërues i ftuar) nga fusha e kandidatit, kandidati Armend Mehmeti ka marr pjesë në këto konferenca shkencore:

Nr.	Autori/autorët/ prezantuesi	Titulli i kumtesës	Emri i konferencës, simpoziumit, organizatori	Vendi dhe viti
1.	Armend Mehmeti	Politika e jashtme britanike, Ballkani dhe Shqipëria(vitet '30 të shek. XX)	“Shqipëria mes të dy luftërave botërore: aspekte të politikës, të së drejtës dhe shoqërisë shqiptare në vitet 1925-1939”, Instituti i Historisë Tiranë dhe Fakulteti i Drejtësisë/Universiteti i Tiranës	Tiranë, 14 dhjetor 2023
2.	Armend Mehmeti	Resurset e naftës faktorë në ndryshimin e relacioneve ndërkombëtare në Evropë në fillim të shekullit XX	Konferencë shkencore: “Çështja shqiptare në Konferencën e Ambasadorëve në Londër (1912-1913)” Instituti i Historisë “Ali Hadri” Prishtinë dhe Fakulteti Filozofik/UP	Prishtinë, 26 tetor 2023
3.	Armend Mehmeti	Qëndrimi jugosllav ndaj Qeverisë Noli	“Fan S. Noli” personalitet i gjithanshëm”, Konferencë shkencore me rastin e 140 vjetorit të lindjes së Fan S. Nolit Akademia e Shkencave të Shqipërisë dhe Universiteti i Korçës “Fan S. Noli”	Tiranë, 17 qershor 2022
4.	Armend Mehmeti	Krimet e forcave serbe në Kosovë ndërmjet dy luftërave botërore (1918-1941)	Konferencë shkencore: “Gjenocidi serb kundër shqiptarëve gjatë shek. XIX-XX” Instituti i Historisë “Ali Hadri” Prishtinë, Instituti i Historisë Tiranë, dhe Instituti Albanologjik Prishtinë	Prishtinë, 7-8 prill 2022

Sipas Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve të Institutit të Historisë, përkatësisht **Shtojcës II, pika C, tabela 1.2: Kryeredaktor, redaktor shkencor, recensues në botime monografike, dokumente dhe përmbledhje:**

Nr.	Kontributi (redaktor, recensues...)	Autori original i librit	Titulli i librit	Vendi dhe viti
1.	Armend Mehmeti Recensent	Beqir Meta, Erjon Dervishi, Hasan Bello	<i>Vatra dhe shqiptarët në Amerikë 1912-1990 (Monografi)</i>	Instituti i Historisë, Prishtinë, 2020
2.	Armend Mehmeti Recensent	Beqir Meta, Hasan Bello	Vatra dhe shqiptarët në Amerikë – Dokumente Historike I 1912-1944 (Vëllim me dokumente)	Instituti i Historisë, Prishtinë, 2020
3.	Armend Mehmeti Recensent	Beqir Meta, Hasan Bello	Vatra dhe shqiptarët në Amerikë – Dokumente Historike II 1945-1958 (Vëllim me dokumente)	Instituti i Historisë, Prishtinë, 2020
4.	Armend Mehmeti Recensent	Beqir Meta, Hasan Bello	Vatra dhe shqiptarët në Amerikë – Dokumente Historike III 1959-1971 (Vëllim me dokumente)	Instituti i Historisë, Prishtinë, 2020
5.	Armend Mehmeti Recensent	Beqir Meta, Hasan Bello	Vatra dhe shqiptarët në Amerikë – Dokumente Historike IV 1972-1990 (Vëllim me dokumente)	Instituti i Historisë, Prishtinë, 2020
6.	Armend Mehmeti Recensent	Avni Rexha	<i>Arsimi i lartë në Kosovë 1991-1991 (Monografi)</i>	Shtëpia Botuese “Libri Shkollor”, Prishtinë, 2021.

Sipas Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve të Institutit të Historisë, përkatësisht **Shtojcës II, pika C, tabela 1.4: Kontribute tjera profesionale-shkencore:**

Nr.	Autori/autorët	Lloji i kontributit shkencor	Vendi dhe viti
1.	Armend Mehmeti	Qëndrimi i Britanisë së Madhe ndaj gjendjes së shqiptarëve në Mbretërinë Serbe-Kroate-Slllovene (1919-1921)	Instituti i Historisë Prishtinë, 2020.

		Revista "Kosova", nr. 46 – 2021 (punim shkencor)	
2.	Armend Mehmeti Marenglen Verli	Shqipëria në dokumentet austro-hungareze viti 1913 Botime me dokumente	Akademia e Shkencave e Shqipërisë 2022-2024
2.	Armend Mehmeti	Anëtar i këshillit organizativ të: Konferencë shkencore: "Gjenocidi serb kundër shqiptarëve gjatë shek. XIX-XX", Instituti i Historisë "Ali Hadri" Prishtinë, Instituti i Historisë Tiranë, dhe Instituti Albanologjik Prishtinë.	Prishtinë, 7-8 prill 2022
3.	Armend Mehmeti	Sekretar shkencor i Institutit të Historisë	Dhjetor 2021 Tetor 2022
4.	Armend Mehmeti	Recensent i disa punimeve të dorëzuara për t'u botuar në kuadër të punimeve të konferencës shkencore: "Gjenocidi serb kundër shqiptarëve gjatë shek. XIX-XX".	
5.	Armend Mehmeti	Anëtar i këshillit organizativ për prezantimin e botimeve të Institutit të Historisë në Panairin e librit në Tiranë	Tiranë, prill 2022

Sipas Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve të Institutit të Historisë, përkatësisht **Shtojcës II, pika D, tabela 1.1:** Pjesëmarrje e dëshmuar në programe ose projekte të kërkimeve shkencore:

Nr.	Programi/projekti shkencor	Periudha kohore	Pozicioni në projekt	Institucioni dhe vendi
1.	Historia e Kosovës	Në proces	Studiues	Instituti i Historisë Prishtinë
2.	Gjenocidi kundër shqiptarëve gjatë shek. XIX-XX	Në proces	Studiues	Instituti i Historisë Prishtinë
3.	Shqipëria në dokumentet austro-hungareze 1913	Në proces	Studiues	Akademia e Shkencave e Shqipërisë

KONKLUZION

Bazuar në dokumentacionin e nevojshëm dhe kushtet e konkursit të shpallur nga Instituti i Historisë “Ali Hadri” në Prishtinë, të publikuar gazetën “Epoka e Re” e datës 29 janar 2024 dhe në ueb faqen e Institutit të Historisë “Ali Hadri” Prishtinë <https://ih-rks.org/konkurs-bashkepunetor-i-larte-shkencor-per-periudhen-ne-mes-te-dy-luftërave-boterore-zgjedhje-rizgjedhje/>, për vendin e punës *Bashkëpunëtor i lartë shkencor për periudhën në mes të Dy Luftërave Botërore – zgjedhje/rizgjedhje*, dhe bazuar në nenet 30, 31, 33 dhe 35 të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore (Gazeta e Republikës së Kosovës, nr. 11/02 maj 2013), nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L212, neneve 29, 30, 31, 32, 33 dhe 34 të Statutit të Institutit të Historisë “Ali Hadri” në Prishtinë, dhe nenet 3, 5, 9, 11, 12 dhe 13 të *Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve në Institutin e Historisë “Ali Hadri” Prishtinë*, Komisioni recensues në përbërje prof. dr. Sabit Sylja - kryetar, prof. dr. Sabile Keçmezi Basha – anëtar, dhe akad. Prof. dr. Frashër Demaj – anëtar, ka arritur këtë konkluzion:

Kandidati Armend Mehmeti ka paraqitur dëshmi të gjashtë (6) punimeve shkencore, nga fusha dhe nga periudha përkatëse e studimit, të indeksuara në platforma relevante ndërkombëtare apo kombëtare në pajtim me nenin 33 pika 2 të *Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore* (Gazeta e Republikës së Kosovës, nr. 11/02 maj 2013), nenit 29 të Statutit të Institutit të Historisë dhe me nenin 5, pikat 1.3.1 të *Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve* të Institutit të Historisë, të paraqitura në tabelën e parë. Pasi dispozita e fundit (neni 5, pika 1.3.1) parasheh kushtin prej tre (3) punimesh të indeksuara në platforma relevante dy (2) prej të cilave pas zgjedhjes së fundit, punimet e mbetura shfrytëzohen si barasvlerë e monografisë dhe librit me dokumente për të plotësuar nenin 1.3.2 *Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve* të Institutit të Historisë, në pajtim me nenin 4, pika 1.3.1 të po kësaj rregulloreje. Është për të shtuar se gjitha punimet e cekura më lartë janë të indeksuara në platforma ndërkombëtare në pajtim me kriteret e mësipërme, të dëshmuara nga linqet aktive në kohën e këtij recensionit, apo të barasvlefshme me 1 pikë dhe i përkasin ekskluzivisht periudhës midis dy luftërave botërore, njëjtë sikurse edhe në monografinë me disa autorë “Drenica në fokusin e historisë” ku kontributi i kandidatit shtrihet në vitet 1912-1941 duke mbuluar kështu gjerësisht periudhën midis dy luftërave botërore, sikurse parasheh konkursi dhe fusha profesionale e kandidatit në fjalë.

Dëshmitë e parashtruara argumentojnë pjesëmarrjen e kandidatit Armend Mehmeti në konferenca, tryeza dhe aktivitete tjera shkencore vendore dhe ndërkombëtare – të përshkruara më lartë në formë tabelare, duke u përfshirë edhe në projektet shkencore individuale dhe kolektive, kryesisht brenda fushës së përcaktuar. Në cilësinë e studiuesit kandidati në fjalë është i përfshirë në projektin e Historisë së Kosovës, projektin Gjenocidi që drejtohet nga Instituti i Historisë, po ashtu në cilësinë e studiuesit është i përfshirë edhe në projektin me vëllime dokumentare austro-hungareze në kuadër të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Në këtë mënyrë kandidati demonstroi përvojë afatgjate në kërkime shkencore të drejtuara nga institucione relevante.

Duke marr parasysh argumentet e cekura më lartë si dhe përgatitjen adekuate për periudhën e caktuar dhe përvojën e krijuar brenda Institutit të Historisë “Ali Hadri” në Prishtinë, Komisioni recensues ka ardhur në përfundim se kandidati prof. ass. dr. Armend Mehmeti ka të arritura dhe kontribute shkencore të profilizura për periudhën e caktuar, kualifikimin dhe përvojën e duhur, që i mundësojnë zgjedhjen dhe vazhdimin e marrëdhënies së punës sipas pozitës së kërkuar në konkurs, respektivisht ka plotësuar gjitha kushtet e parapara me nenin 33 pika 2 të Ligjit nr. 04/L-135 për *Veprimtari Kërkimore-Shkencore* (Gazeta e Republikës së Kosovës, nr. 11/02 maj 2013), nenit 29 të Statutit të Institutit të Historisë dhe me nenin 5 - Shtojcat I-A, II-B, C dhe D të *Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve* të Institutit të Historisë në Prishtinë.

Propozim

Komisioni recensues në përbërje prof. dr. Sabit Syla - kryetar, prof. dr. Sabile Keçmezi Basha – anëtar, dhe akad. Prof. dr. Frashër Demaj – anëtar, bazuar në kriteret dhe dispozitat ligjore të përcaktuara në preambulë të këtij konkursi, dhe në të arriturat profesionale-shkencore të përshkruara dhe të dokumentuara më lartë, për vendin e punës *Bashkëpunëtor i lartë shkencor për periudhën në mes të Dy Luftërave Botërore – zgjedhje/rizgjedhje*, në Institutin e Historisë “Ali Hadri” në Prishtinë, propozon kandidatin prof. ass. dr. Armend Mehmeti.

Komisioni recensues:

Prof. dr. Sabit Syla – kryetar

Prof. dr. Sabile Keçmezi Basha – anëtare

Akad. prof. dr. Frashër Demaj – anëtar

